



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/24/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. M.D ndaj gjyqtarit J.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 11.11.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. M.D ndaj gjyqtarit J.M, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës av. M.D përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.M, ankesë kjo e cila është dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 25.10.2024.

Parashtruesi i ankesës av. M.D ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.M me pretendimet se të gjitha çështjet e saj në cilësinë e avokates po gjykohen nga një gjyqtar që nuk ka asnjë cilësi, ku sipas saj sjellja e tij, mungesa e ekspertizës, mosnjohja e procedurës dhe keqinterpretimi i ligjit dërgojnë në faktin se të gjitha vendimet e tij janë të tilla që palët pësojnë më së shumti kur kemi parasysh se për shkak të ngarkesës të Gjykatës së Apelit, procedurat e ankesave zgjasin shumë, andaj sipas saj gjyqtari J.M po pret të kalojë koha dhe të dal në pension dhe po sillet në mënyrë jo profesionale siç nuk duhet të sillet një gjyqtar. Tutje ka deklaruar se i është drejtuar vazhdimisht gjyqtarit mbikëqyrës i cili thotë se të gjithë ankohen për të, ndaj ndihet e detyruar që të kërkoj nga Kryetarja e Gjykatës që të kërkoj nga Komisioni i Vlerësimit të Gjyqtarëve që ti kontrollojnë aftësitë e tij profesionale dhe nëse i njëjti nuk i plotëson të gjitha kriteret në përputhje me Rregulloren për Vlerësimin e Gjyqtarëve, të shkarkohet.

Ndër të tjerash ka deklaruar se ka qenë e durueshme dhe ka menduar se pas një kohe gjyqtari do të fillojë të punojë siç duhet, por çdo ditë sipas saj gjendja po përkeqësohet, pasi që i njëjti po merr vendime të paarsyeshme dhe me shumë gabime, ka një mënyrë të interpretimit të ligjit që fatkeqësisht është në dëm të palëve, po ashtu procedurat që kanë karakter urgjent dhe që duhet të trajtohen brenda afateve ligjore, po mbahen në sirtarë nga gjyqtari J.M.

Në fund ka kërkuar që të merret seriozisht kjo ankesë sepse në këtë degë palët e pësojnë dënim më të madh nga ky gjyqtar i cili po nxjerr vendime të çuditshme.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka filluar deklarimin e tij duke parashtruar pyetje se nga i buron e drejta - autorizimi avokates për të vlerësuar sjelljen e tij, profesionalizmin dhe nëse i njëjti e interpreton ligjin drejt apo gabim. Sipas tij, a do të thotë kjo se ajo

është kryetare apo anëtare e komisionit për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, anëtare e Këshillit Gjyqësor, kryetare e gjykatës apo profesoreshë në Fakultetin Juridik dhe unë jam student i saj? Tutje ka deklaruar se në lidhje me pretendimet se gjyqtari mban lëndë urgjente në sirtar ngre pyetjen se nga e di ajo që gjyqtari mban lëndë urgjente në sirtar, apo ndoshta bëhet fjalë për informata të gabuara që ajo merr nga bashkëpunëtorët e saj apo informatorët nga gjykata. Po ashtu gjyqtari ka deklaruar se deklarimi i avokates në fjalë se për shkak të sjelljes së tij po pëson pasoja të dëmshme sepse i njëjti nuk po merre vendime të drejta, siç konsideron ajo, ndoshta mendon se duke marrë vendime sipas vullnetit të saj mund të përfitojë më shumë dhe në këtë mënyrë ta frenojë lakminë e saj.

Sipas tij, është e vërtetë që shpesh avokatja në fjalë e pyet pse merre vendime të tilla që nuk janë sipas vullnetit të saj, të cilës sipas tij ai i përgjigjet rregullisht që për lëndët që nuk janë objekt shqyrtimi, të mos e pyet asgjë jashtë seance.

Në fund ka deklaruar se znj. M.D hyn në zyrën ku i njëjti punon pa paralajmërim, duke kërkuar që t'i caktoj seancat në të cilat ajo është avokate dhe pas përgjigjes se rastet e saj janë të datave të reja dhe se ajo duhet të presë radhën, ajo fillon ta ofendojë dhe nënçmojë dhe për të cilat raste gjyqtari ka deklaruar se do ta informoj Odën e Avokatëve të Kosovës.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit J.M.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të ankesës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për shkelje të ligjit a po për shkelje të detyrave të tij zyrtare si gjyqtar, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Pretendimet për marrje të vendimeve të paarsyeshme dhe me gabime, mosnjohje të procedurës a po keqinterpretim të ligjit, të cilat rrethana sipas parashtruese së ankesës po dërgojnë gjyqtarin në marrje të vendimeve jo të drejta, Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarëve a po mënyrën e trajtimit të lëndës nga ana e tyre. Nëse palët konsiderojnë se gjyqtari i çështjes ka shkelur dispozitat ligjore a po dispozitat procedurale të parapara me legjislacionin në fuqi a po nuk ka bërë zbatim të duhur të të drejtës materiale, atëherë palët gjithmonë udhëzohen në përdorimin e mjeteve të rregullta a po të jashtëzakonshme juridike për atakimin e vendimeve në shkallët më të larta, **por vendimmarrja e gjyqtarit nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.**

Vërtetimet a po vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë në dëm a po në dobi të palës, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtarin, a po të pretendohet se gjyqtari i çështjes është treguar i paanshëm a po ka shkelur parimin e pavarësisë, kjo sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Sa i përket pretendimit se gjyqtari i lëndës nuk po cakton lëndët gjyqësore të karakterit urgjent, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë të dhënë për këto lëndë, në mënyrë që të kërkohet përgjigje a po të hulumtohet në lidhje me ekzistimin e a po jo të kësaj rrethane, duke bërë kështu që ky pretendim të mbetet i paprovuar.

Po ashtu, parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë që të mbështesë pretendimin se gjyqtari në fjalë është sjellë në mënyrë jo profesionale me të njëjtën, a po ka shkelur rregullat e parapara me Kodin e Etikës Profesional për Gjyqtarë.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, **në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit**".

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/24/24, me datë 11.11.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë